



Më
dina

17 - 12 - 2018

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:053834

Datë: 02.11.2018

Numri i dokumentit: 00165106

P.nr.1630/2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NFRIZAJ, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Adem Shabani dhe zyrtaren ligjore Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED], nga fshati [REDACTED] Komuna Gllogoc, për shkak se ka kryer veprën penale deklarim i rremë nga neni 392 par 2. lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/I.nr.2335-4/2016 të dt.26.01.2017, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të pandehurit [REDACTED] dhe imbrojtësit të tij me autorizim Av. [REDACTED] nga Prishtina, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më datën 02.11.2018, gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDACTED], me vendbanim në Prishtinë rruga [REDACTED] "Llamella" nr. [REDACTED] i lindur me datën [REDACTED], në fshati [REDACTED] Komuna Gllogoc nga babai [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës, , ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i pesë fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal numri personalë [REDACTED]

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

-me datën 19.07.2017 në Podujevë në zyrën e noterit [REDACTED] kanë deklaruar rrejshëm para noterit se e njohin [REDACTED] shtetase serbe, në procedurë përvërtetimin e identitetit të saj në përpilimin e aktit notarial- autorizimit me numër 4522/2016 të datës 17.09.2016, dhe i njëjtë deklarim është marrë si vendim përfundimtar në procedurën e përpilimit të këtij autorizimi,-

- me këtë ka kryer veprën penale deklarim i rremë nga neni nga neni 392 par 2. lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75 par.1.3, 76 dhe nenit 392 par 2. lidhur me par.1 të KPRK-së , dhe neneve 365 , 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, i shqipton këtë:

DËNIM ME BURGIM

I. Të pandehurin [REDAKTUE], e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

II. Duke u bazuar në nenin 47 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €uro, të cilin dënim duhet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 €uro (njëzet euro), të papaguara do t'i llogaritet 1(një) ditë burg.

IV. Detyrohet i pandehuri [REDAKTUE] që në emër të pashallit gjyqësor të paguaj shumë prej 20 (njëzet €uro, kurse në emër të kompensimit të viktimate të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) €uro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2335-4/2016 të dt.26.01.2017, ka ngarkuar të pandehurit [REDAKTUE] për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së dhe veprës penale legalizimi i përbajtjes së pavërtetë nga neni 403 par 1 të KPRK-së, si dhe ndaj të akuzuarit [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] për shkak të veprës penale deklarimet e rreme nga neni 392 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 10.02.2017, ka caktuar shqyrtimin fillestar, ku prokurori i shtetit ka propozuar që pasi mungon i pandehuri [REDAKTUE] të cilin nuk kanë mundur ta sigurojnë as në procedurën hetimore për shkak të ekonomizimit të procedurës penale ka propozuar që procedura penale ndaj të pandehurit [REDAKTUE] të veçohet, me të cilin propozim jan pajtuar edhe i pandehuri [REDAKTUE] dhe mbrojtësi i tij si dhe i pandehuri [REDAKTUE]

Gjykata pas marrjes së mendimit të palëve, mbrojtësit të pandehurit [REDAKTUE], Av. [REDAKTUE], të pandehurve [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE], ka aprovuar propozimin e prokurorit të shtetit që procedura penale kundër të pandehurit [REDAKTUE] të veçohet dhe ndaj tij procedura penale të vazhdohet ndaras, dhe është obliguar administrata e gjykatës, përkatësisht Zyra e menagjimit të lëndëve që të regjistroj me numër të veçantë lëndën penale për të pandehurin [REDAKTUE] sipas aktakuzës PP/II.nr.2335-4/2016 të dt.26.01.2017.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me datën 02.11. 2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit, Ismet

Ibrahimani, i pandehuri [REDACTED] dhe mbrojtësi i tij me autorizim Avokati Mr.sc [REDACTED], nga Prishtina.

Në fillim të shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të pandehurit janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën të pandehurit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjtë e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtë i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lichur me veprën penale për të cilën akuzohet dhe para se të deklarohet të konsultohet me mbrojtësi e tij.

I pandehuri [REDACTED], në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranoj fajësinë, për veprën penale që akuzohet dhe është e vërtetë sae ka deklaruar para noterit se e nef personalisht zonjën e cekur më lartë, por është e vërtetë se nuk e ka njohur personin për të cilin ka deklaruar, por nuk ka menduar se do të ketë pasoja, por e ka ftuar shoku [REDACTED] që të deklarohet në lidhje me identitetin e zonjës [REDACTED], ku edhe ka deklaruar pa e njohur fare i kërkoj falje publike gjykatës për këtë veprë penale që e ka kryer, është rasti i parë që ballafaqohem me shkelje të ligjit, gjykatës përfshirë që e ka rastin e shqiptimit të dënimit ét merre për bazë të gjitha rrëthanat mirëpo edhe pas këtij rasti nuk kam pasur asnjë rast dhe nuk do të kem asnjëherë, është majtës i familjes baba i pesë fëmijëve, i pa punë.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, lichur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se konsideroj se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në perputhje me dispozitat ligjore të parapara në dispozitën e nenit 248 par.1. të KPPK-së si dhe provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit [REDACTED] Av. [REDACTED], lichur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij për verën penale që akuzohet në shqyrtimin fillestar pajtohet me pranimin e fajësisë dhe propozoj gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit ét merre për bazë të gjitha rrëthanat lehtësuese dhe ti shqiptoj një dënim minimal.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale deklarim i rremë nga nen 392 par 2. lichur me par.1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtorë dhe i'u shqiptua dënimë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrëthanat e parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrëhana lehtësuese

Eti faktin se i akuzuari, gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndjen shumë keqardhje për rastin, pendimin e thellë, sjelljen e tij pas këtij rasti, si dhe premtimin se nuk do ta përsëris të njëjtën vepër penale apo tjera, është i pa punë, i martuar baba i pesë fëmijëve, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky përgjegjësisë penale si rrëthana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënitit i paraparë me nenin 41 par.1 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjera nga kryerja e veprave të tillë penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga veprat dytërimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënitit me burgim në dënim me gjobë është marrë në kuptim të nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi mbi kompensimin e viktimave është marrë në bazë të nenit 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimtit.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënparr.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimtit Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1630/2017 me datë 02.11.2018

Zyrtarja ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.